



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Shkurt 2022

Nr: 103

V E N D I M

P Ë R

**SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË “BI MEDIA”, “ABC”, “RTSH”,
DHE “STAR PLUS TV”, PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR
KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 25.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

- KËRKUES:**
- 1.“BI MEDIA”, me seli në Bulqizë, Rruga “Këshilli i Rrethit”, me përfaqesues z. Sami Curri.
 2. “ABC”, me seli në Tiranë, Rruga “Aleksandër Moisiu” (ish Kinostudio) dhe përfaqësues z. Andi Tela;
 3. “RTSH”, me seli në Tiranë, me përfaqësues z. Bledar Zaganjori;
 4. “Star Plus TV”, me seli në Shkodër, Rruga “Kole Idromeno” dhe përfaqësues z. Senad Nikshiqi

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues i gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008,“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021, të Komisionit Rregullator, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,



VËREN:

“BI Media” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator. “BI Media” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Televizioni “ABC” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 24 (njëzet e katër) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator. Televizioni “ABC”, është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“RTSH” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 82 (tetëdhjetë e dy) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022, të Komisionit Rregullator. “RTSH” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

“Star Plus TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur nuk respekton afatin kohor të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator. “Star Plus TV” është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Kërkesat e paraqitur nuk janë dorëzuar brenda afatit procedural të përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator. Subjektet kërkuese gëzojnë të drejtën të caktojnë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe përmbushin kushtin ligjor.

Afatet në procedurën administrative janë me rëndësi të veçantë për krijimin ose humbjen e ndonjë të drejte të palës. Afati i përcaktuar në pikën 11, të vendimit nr.2/2022 të Komisionit Rregullator i cili përcakton se kërkesat e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqiten Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve jo më vonë se data 18 Shkurt 2022, paraqet një interval të caktuar kohor, brenda të cilit duhet të kryhet veprimi në procedurën administrative. Afati procedural i vendosur nga Komisioni Rregullator, në kuptim të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, nuk përbën afat të karakterit prekluziv, mosrespektimi i të cilit do të sillte humbjen e së drejtës subjektive të palës. Komisioni Rregullator, në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme, ka arsyetuar dhe vendosur një afat të logjikshëm për palët kërkuese nga njëra anë për realizimin e së drejtës së tyre të ligjshme për të pasur vëzhgues në zgjedhje, dhe nga ana tjetër, për vetë administratën e KQZ-së për të kryer veprimet procedural përkatëse. Kërkesa e paraqitur për realizimin e së drejtës së palës kërkuese dhe mosrespektimi i afatit procedural nuk sjell humbjen e të drejtën për të kryer veprimin procedural, të cilin është dashur ta kryejë brenda afatit të caktuar.

Në çdo rast, vendosja e këtij afati procedural konsideron garantimin e sigurisë juridike dhe standardeve të rëndësishme për një proces të rregullt zgjedhor. Afatet në këtë rast nuk janë indikative, në kushtet kur implikojnë cënim të standardit zgjedhor. Pika 2, e nenit 6, të Kodit Zgjedhor parashikon se, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të medias kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues në zgjedhje. Në këtë kuptim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve arrin në konkluzionin se afati i parashikuar në pikën 11, të vendimit nr.2/2022 të Komisionit Rregullator nuk është afat prekluziv, që të përbënte kusht për refuzimin e kërkesës dhe moszbatimin e afatit tërësor të akreditimit të vëzhguesve përpara datës së zgjedhjeve. Interpretimi ndryshe i kësaj dispozite, do t'i mohonte kërkuarit të drejtën për të caktuar vëzhgues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021, të Komisionit Rregullator, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 2 (dy) gazetarëve “BI Media”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi
2. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 24 (njëzet e katër) gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit “ABC”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 82 (tetëdhjetë e dy) gazetarëve dhe operatorëve të RTSH sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 19 (nëntëmbëdhjetë) gazetarëve dhe operatorëve të Star Plus TV, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

